



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-19-4596-1-3-6/C186
14 Nr. 761/19
Dt. 19.08.2019

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **A.R.F. “ sh.p.k.** me seli në **Fushë Kosovë**, me NrUI : **811255109** e Nr. Fiskal: **601268479**, të cilën e përfaqëson **z. Avdi Koca**, në tekstin e mëtejme: **FURNIZUESI** ,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizime shënuara me poshtë: **Furnizimi me material pedagogjik** , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	45	9	6	1	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	7	5	1	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi me material pedagogjik për shkolla**, në pajtim me Specifikat Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit : **jo më larg se data 31.08.2019**.
- 1.3 Vendi i dërgimit të materialit (materialit pedagogjik sipas Përshkrimit të Çmimeve) do të jenë shkollat sipas regjistrimit të Njesisë së Kërkesës.
- 1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 7.973,43€ (shtatmijënjëqind e shtatdhjetë/43 Euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim nga Komisioni i Pranimit të Mallit .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve dhe / ose shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:


- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:
“ A.R.F. “sh.p.k. – Fushë Kosovë

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

Emri:	Avdi Koca	Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.08.2019	Data:	19.08.2019
Vula:		Vula:	

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G

Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, çmimi duhet shkruhet në 2 (dy) decimale pasë presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Vlera (Pa TVSH)	TVSH	Vlera (me TVSH)-€
1	Ditar për parafillor (me kurrikulë)	Copë	47	7.20	18.00	8.50	338.56	60.94	399.50
2	Ditar për grupmosha 1-5 vjet	Copë	6	7.20	18.00	8.50	43.22	7.78	51.00
3	Ditar klase, Klasa I dhe II (me kurrikulë)	Copë	115	7.20	18.00	8.50	828.39	149.11	977.50
4	Ditar klase, Klasa e III-të, IV dhe V-të (me kurrikulë)	Copë	66	7.20	18.00	8.50	475.42	85.58	561.00
5	Ditar klase, Klasa e IV dhe V-të (pa kurrikulë)	Copë	96	7.20	18.00	8.50	691.53	124.47	816.00
6	Ditar klase, Klasa e VI deri të IX-të (me kurrikulë)	Copë	160	7.12	18.00	8.40	1,138.98	205.02	1,344.00
7	Ditar klase, Klasa e IX-të, (pa kurrikulë)	Copë	61	7.20	18.00	8.50	439.41	79.09	518.50
8	Shkumësia të bardhë	Copë	1471	0.81	18.00	0.95	1,184.28	213.17	1,397.45
9	Shpuza për tabelë	Copë	1251	0.24	18.00	0.28	296.85	53.43	350.28
10	Ditar individual për shkollen e muzikës	Copë	8	8.39	18.00	9.90	67.12	12.08	79.20
11	Libër amë për klasën V-të (me kurrikulë)	Copë	2	12.71	18.00	15.00	25.42	4.58	30.00
12	Libër amë për klasën e VI-të deri IX-të (me kurrikulë)	Kuti	6	12.71	18.00	15.00	76.27	13.73	90.00

13	Libër protokoli të dëftesave	Copë	2	3.39	18.00	4.00	6.78	1.22	8.00
14	Ditar për shkolla të mesme teknike (pa kurrikulë)	Copë	47	7.20	18.00	8.50	338.56	60.94	399.50
15	Ditar klase, Klasa X-XI-XII për gjimnaz (me kurrikulë të re)	Copë	43	7.20	18.00	8.50	309.75	55.75	365.50
16	Ditar klase për shkolla të mesme profesionale (me kurrikulë)	Copë	46	7.20	18.00	8.50	331.36	59.64	391.00
17	Libër amë për shkolla profesionale (me kurrikulë)	Copë	4	12.71	18.00	15.00	50.85	9.15	60.00
18	Libër amë për gjimnaz shkolla të mesme teknike (pa kurrikulë)	Copë	3	12.71	18.00	15.00	38.14	6.86	45.00
19	Libër amë për gjimnaz (sipas pilot kurrikulës së re)	Copë	3	12.71	18.00	15.00	38.14	6.86	45.00
20	Libër protokoli për shkollën profesionale (pa kurrikulë)	Copë	3	12.71	18.00	15.00	38.14	6.86	45.00
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH:							6,757.14	1,216.29	7,973.43

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	ARF shpk
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Avdi Koca
NËNSHKRIMI:	
DATA:	03.07.2019
VULA:	